

VENDIM
Nr.143, datë 29.12.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S
NR.13, DATË 28.1.2008 “PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR NDËRTIMIN DHE
SHFRYTËZIMIN E CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË DHE PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE” (PARKU EOLIK PROJEKTI VISU DHE TERPAN)**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “ALB WIND ENERGY” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të përcaktuara në vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.13, datë 28.1.2008 “Për dhënien e licencës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike” (Parku eolik projekti Visu dhe Terpan), dhe e konsideroi të drejtë kërkesën e shoqërisë “ALB WIND” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.13, datë 28.1.2008 “Për dhënien e licencës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike “ (Parku eolik, projekti Visu dhe Terpan) bëhen këto ndryshime:

- në pikën 1, afati prej 12 muajsh ndryshohet dhe bëhet 21 muaj;
- në pikën 4, afati prej 36 muajsh ndryshohet dhe bëhet 45 muaj.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 13, datë 28.1.2008.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta